



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës me nr. 17384 Prot. datë 02.07.2026 ku kërkohet informacion mbi krijimin e kategorisë “plazhe publike të tarifuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ju bëjmë me dije se:

1. Menaxhimi i sipërfaqeve të plazhit publik me pagesë në plazhin e Velipojës përbën një nga projektet pilot të Bashkisë Shkodër. Bashkia është angazhuar maksimalisht për zbatimin me sukses të këtij modeli, me synim ofrimin e një shërbimi cilësor dhe rritjen e frekuentimit nga pushuesit. Theksojmë se krijimi i këtyre sipërfaqeve të menaxhuara me pagesë nuk ka cenuar sipërfaqet publike pa pagesë, të cilat vazhdojnë të jenë të aksesueshme, të mirëmbahen rregullisht dhe të frekuentohen nga një numër i konsiderueshëm pushuesish.

2. Tarifat për përdorimin e plazheve publike me pagesë janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Skodrinon.al" sh.a., me Vendimin nr. 6, datë 29.05.2026.

3. Të ardhurat e realizuara nga tarifimi do të përdoren për financimin e investimeve publike dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe vizitorët.

4. Parashikimi i të ardhurave është hartuar përpara fillimit të investimit, bazuar në analizën e pritshme të përdorimit dhe frekuentimit të këtyre hapësirave nga publiku. Sipas kësaj përlllogaritjeje, të ardhurat neto vjetore parashikohen të jenë rreth 3,000,000 (tre milionë) lekë. Megjithatë, për Bashkinë Shkodër prioritet mbetet ofrimi i një shërbimi cilësor brenda kostove të përballueshme, duke garantuar tarifa të arsyeshme dhe të aksesueshme për pushuesit.

5. Tarifa e shërbimit përfshin përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe shërbimeve, konkretisht:

- pastrimin e plazhit;
- tualetet publike;
- dushet;
- shërbimin e rojes së plazhit;

6. Informimi i qytetarëve dhe vizitorëve mbi këtë shërbim realizohet përmes faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër si dhe materialeve promocionale.

7. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

- Hartën e stacioneve të plazhit Velipojë dhe Rrjoll për sezonin turistik 2026;
- Vendimin nr. 6, datë 29.05.2026, të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Skodrinon.al" sh.a.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Alban PREKA

Konceptoi: *B. Çelaj*

Pranoi: *D. Dragani*

Miratoi: *M. Kapsaj B. Mema*



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
"SKODRINON" SH.A.**

Nr. 333 prot,

Shkodër, me datë 29/05/2026

V E N D I M

Nr. 6, datë 29.05.2026

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË RI TË TARIFAVE PËR AKOMODIMIN E
PUSHUESVE NË STACIONET E PLAZHEVE PUBLIKE TË MENAXHUESHME
NGA SHOQËRIA AKSIONARE SKODRINON SH.A."**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionare "SKODRINON" sh.a., me aksionar të vetëm Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, në mbledhjen e datës 29.05.2026, me propozim të Këshillit të Administrimit të shoqërisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.8.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, neni 135 pikat 1, 2 si dhe pika 4, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 20.7.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare " BIO STRAJCA " sh.a., si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e akt themelimit dhe statutit", në referim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 28, datë 29.05.2025 " Për dhënie pëlqimi,shëtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare " Bio Strajca" në pronësi të bashkisë Shkodër", Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", në kuadër të kompetencave të parashikuara në nenin 7, gërma c),të Statutit të kësaj shoqërie, si dhe në mbështetje të Vendimit nr.6, datë 11/05/2026 të Këshillit të Administrimit;

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të ri të tarifave për akomodimin e pushuesve në stacionet e plazheve publike në Velipojë dhe Rrjoli , të cilat janë të menaxhuara dhe administruara nga shoqëria ,si me poshtë :
 - 1.1 Tarifë ditore për 1 (një) set çadra dhe shezillone (2 krevate+ 1 çadër) = 400 (katërqind) lekë, për stacionet e plazheve publike në Velipojë .
 - 1.2 Tarifë ditore për 1 (një) set çadra dhe shezillone (2 krevate+ 1 çadër)= 300 (treqind) lekë për për stacionet e plazheve publike në Rrjoll.
2. Pika 2 e Vendimit Nr. 9, datë 20.06.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë , shfuqizohet
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare i fillojnë me datë 01.06.2026
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i shoqërisë.

PËR ASAMBLENË PËRGJITHSHME

**PËRFAQËSUAR
KRYETAR
BENET BECI**





